

BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-1
H 63

AGIM HILA

KUR
BISEDOJME
NE
USHTARET

Vjersha dhe ballada

891.183-1

H 63

AGIM HILA

S.

KUR BISEDOJMË
NE
USHTARET

(Vjersha dhe balada)

~~566/5~~
12640



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NË SHTËPI

Vij nga larg,

(një çantë mbaj në shpinë)
gjithë djersë në ballë e në xhaketë,
ngjit një kodër, ulem në lëndinë,
si një ditë pranvere kjo vjeshtë e tretë.

Që nga larg më sjell një këngë labçë,
Gryk e Puse nga stanet në mal:
— Na solli Partia dritë jete,
na ngriti këtu hidrocentral!...

Yjet, që gjer tash më shoqëronin,
porsi frymëzimi romantik,
lart, atje, tek rrjedh prroi i Honit,
u shkrinë nën refleksin elektrik... .

O fshati im, sa shpejt veshjen ndryshove,
ç'të shkoka rrobja e dritës — ngjyrë ar!
E unë që veç nga larg t'imagjinoja,
s'të njoha dot në këtë darkë — behar!

ME TY, O KOMANDANT

— O Komandant! — thirri ushtari
Haxhi Shahini dhe u hodh të për-
jetësohej bashkë me të.

Sa herë që bie vjeshta mbi Kaptinë,¹
një vit më afér të bien zemrat tonë,
Në rrëzë të malit me ty së bashku vijmë,
nga pas na ndjek me dashuri jehona

e asaj vjeshte mbarsur héroizëm,
e asaj mbrëmje ngjyer në brilant,
kur thirre ti dhe malet gjithë thirrën:
— «Për ty, me ty, i dashur komandant!...»

Ne, njeri-tjetrit, në halle e gëzime,
ju gjendem pranë; çdo gjë e ndamë së bashku.

1. Majë mali në Martanesh.

si ujin e pagurit në marshime,
siç ndajnë hallet vëllezërit e dashur.

Dhe jetën do ta falnim për një shok!
Kështu u lidhëm një ditë në shesh-mejdan...
Pra pritëm, dhëmbjen tënde ta ndajmë tok,
Ta marrim bashkë dozën helm-metan!...

C'e deshi vjeshta këtë melodi sublime
për ta buçitur, në çdo altoparlant,
me ligjërim, baladën më intime:
— Të jemi bashkë, vëlla, o komandant!

C'kish rrënëjë kaq të thella kjo baladë,
në rrjedhshmërinë e heroizmit tënd.
C'kish kaq dëshirë të mbetej kjo baladë
në zemrat e poetëve, nëpër këngë.

Dhe vjeshtërat e ligjërojnë për dashurinë,
në çdo podium altoparlant
baladën më intime për njerinë:
— Nuk mund të rrije vëtëm, komandant!...

BASHO CILJA

Qetësinë e shtigjeve ç'e drithëroi alarmi,
nga gryka e Muzinës gjer në Shpë.
Në krisma armësh fluturonte sinjali,
për gatishmëri të plotë, numur një.

Mes natës flakërinin vetëtimat
për t'i zbuluar veshjen tokës krejt,
por nata mbi antena vetëtimat
i mblidhje për t'i ndezur diku gjatkë...

Oh, ç'do t'ju fliste, vëllezër, Basho Cilja
pranë mitralozit të dashur në llogore,
te shteg' i luftës, shrat' i rreptë i tija,
si një legjendë prite popullore.

Nëpër mejtime të tija qarkullojnë
epoka heroike në apele:

Që nga legjistatori Idriz Suli¹
e gjer te armët më moderne

që nga jehona e tetë pushkëve të vjetra,
që mbajtën dyzet ditë një ushtri
dikur, për tokën mëmë, buzë-plasur,
që nxinte nën dushmanin zemërzi...

O, ç'do t'ju fliste me orë Basho Cilja
për grykën e Muzinës gjer në Gjashtë,²
si i bashkoi një ditë armët me shokë
për hakmarrjen e etërve të lashtë,

si brodhën këmbëzbathur pas sinjaleve,
pas thirrjes së luftës clirimtare,
kur buçiste me jehonë maleve:
— O vëllezër, për bijt' e rënë, hakmarrje!...

E kush nga ne s'njeh zënë e Cile Labit?
Hej, zëri i tij ç'kérkon e dinë të gjithë:

1. Legjistator popullor në Kurvelesh, që historikisht, nxori për herë të parë gruan në punë.

2. Në 1914 trimi Halil Suli vetë i tetë luftoi kundër turkut në qafë të Gjashtës për të mbrojtur kufirin.

— Tri metra, mundësishët ta bëjmë hapin
që të parët të gjendemi në pritë.

Dhe e dimë: Kërkesë e tij ka rrënë
që nga legjendat e luftëtarëve në Gjashë.
Ndaj e duam ne atë, si babë e nënë,
Ndaj e duam si shok e komandant.

Ç A S T

Pa uluni, shokë, të rrimë,
të thithim pak ajër të pastër
dhe nga një cigare të pimë;
të kuvendojmë, të çlodhemi pakë...

Moj stinë e qeshur, pranverë
e viseve tonë shqiptare,
që zbret si një vajzë e zhdërvjellët,
me veshje të blertë ushtare,

C'ma ndeze këtë nerv prej liriku
sa s'mund të përbahem më dot
dhe shtrohem të thith frymëzimin,
si erën e luleve, sot...

Për Tit Kolonjarin e vrazhdë
Nikolla lahutës i bie.
Nën tinguj të hollë e të qartë,
nis lart një këngë dashurie.

Çapkën më të madh s'do të kishte,
shakaxhi, se sa ky ushtar!

Ta shihnit, o vëllezër, ju Birçen,
kur mblidhte zogjtë me longar,

të rrinit këtu pak çaste,
të ndiznit me ne një «kaush»,
do i ndjenit pranverën ushtare
t'ju digjte mbi faqe si prush.

Të shihnit se si pas sinjalit,
pas urdhërit të prerë luftarak,
do t'ngjitesh rrufe majëmalit
me hap të sigurtë ushtarak.

MOTIV I BLERTË

Kur varej mbrëmja fushës, nëntingujt e longarit,
ti erdhe pranë meje, si një lirikë ushtari.

Me vete se ç'më sillje gjithë meloditë e fushës
dhe dashurinë — gjerdan ma mbaje rrotull gushës.

Në sytë e tu zbardhonte si velë lumturia,
mes ngjyrash spektrale, që ndizte malësia;

mes mbrëmjes fusharake, mes këngëve të blerta,
që mbushnin misërishtet, si ritme blu të lehta.

Me to dhuratë më sillje gjithë mallin e kujtimeve
me ndjenja të kristalta, si rrjedha e burimeve...

Kështu të ëndërrova një natë kur mbaja në krahë
pushkë,
tek rendja pas një ylli në qiellin e bruztë.

Ish koha kur varej mbrëmja nën ligjërimë longari,
si një lirikë e ngrohtë në zemrën e ushtarit.

MBRËMJA NË FUSHIM

Po bie mbrëmja mbi tokën e kaltër,
përmbi flatrat e muzgut po bie...
Këtë natë, së bashku me shokët,
Po këndojmë këngë trimërie.

Grumbuj-grumbuj mblidhen e vijnë
ëndërrat gazmore të shokëve tanë
mbi shpatulla mbajnë djalërinë,
në zemra dashurinë kanë.

Sikush me vete diçka të tijën bie
në sfondin e gjallë të vegimeve.
Dhe mblidhen porsi në mitingje
brohorimat e gjithë krahinave.

Dhe bashkohen nën këto tinguj të fortë
gjithë krahinat e tokës shqiptarë,
në këtë mbrëmje janari të ftohtë,
që e ngroh kënga e zjarrtë ushtare.

KËSHTU MË THANË

— Partizanes që më vuri emrin Agim —

Kështu më thanë mëma ime dhe hallë Hatua,
që ju gjendën me shokë pranë shtratit të përjetshëm.
Në këtë emër ëndërronte e mallëngjyer çlirimin.
Vallen e brohorimave të fitores së afërt
i sillte në buzëqeshjen e çiltër, ky emër.
Po, ja atje mbi malin e Gjërë,
ku vdekja me fitoren
haheshin si dy ushtri për një kokojkë vendimtare
një ditë në vjeshtën e fundit naziste,
u këput si një yll i zjarrtë floriri

partizania Bardhë,
trimja jonë Bardhë,
motra e dashur Bardhë,

tek emrin-ëndërr shokëve si kurajo sulmi ua
përsëriste.

Kështu më thanë mëma ime dhe hallë Hatua,
që ju gjendën pranë shtratit n'amëshim,
kur shokët thërriste në apel të fitores:
— Tare, Thoma, Petrit xhan' i motrës
ja, po zbardh... Agim!...

RITËM MALESH

Si karakoll rri shpell' e lashtë
mbuluar rrëth me shkure e dushk.
Ne ngjitim pllajën të dy bashkë
unë në këmbë, ai në mushkë.

Me vete na rrëmbej mendimi
i viteve, mbi këto brinja.
Ai mes kohrash ndjen kushtrimin
e unë nis skicoj poezinë...

O baba, thinjat ç't'u shumuan,
kaq dendur ç'po e thith duhanin!
Mos djemtë e fshatit t'u kujtuan?
Këtu u vra vallë xha Fetani?

Për të dikur më pate folur
si brodhët bashkë vend më vend,
gjersa një plumb mizor e mori
për atë majë kështjellë-shkëmb.

Mos t'u kujtua Themo Vasi,
atje mbi shpellën si kala,
kur briti sa gjëmoi fshati:
— Mbi ta, o shokëni, mbi ta...

.....

Na presin mbi shpellën e lashtë,
që rri si truall hijerëndë...
Pa folur ecim të dy bashkë
Ai në mushkë e unë në këmbë.

E presin sot atë rinia,
t'u flasë për guvat, ku dikur
pesë pushkë ngritën, gjer në qiel,
të kuq si gjaku, një flamur.

Dhe ecim bashkë me mendimin
e viteve mbi këtë brinjë.
Ai mes kohrash ndjen kushtrimin
si unë mes ndjenjash poezinë.

O KOMISAR I ÇETËS


O xha Rahman, o xha Rahman
ty nuk t'u ndanë kurrë llogoret,
në çdo stuhi e tramundan',
si në legjendat popullore.

Po plakesh, thinjat po të shtohen,
shpinën ç'ta kërrusi barrë e jetës,
por asnijëherë s'i le llogoret,
s'i le o komisar i çetës.

Sa herë na flet për partizanët,
për shokët, që në luftë mbenë
statujë mermeri, ballë tufanesh,
ne gojën plot: «Për mëmëdhenë!»..

C'të dhemb për Sofo Kapedanë,¹⁾
Për Fato²⁾ motrën gojëmjaltë,

-
1. Sofo Meksi — dëshmor i Luftës nacional çlirimtare
 2. Fato Berberi — dëshmore e Luftës nacional çlirimtare.



që për një ditë si yje ranë
edhe u ndezë si diell i zjarrtë!

Dhe rrudhat ballit se ç'të shtohen,
mendime vitesh të përpijnë
Mes tyresh qmallesh, përgjërohesh
dhe flet, o komisari ynë!

Pastaj i pari në llogore
hidhesh e merr vijë shenjimi...
Përreth urraja e shëmbëllorëve
buçet si gjëmë bombardimi!

S O N T E

Sonte thellë malet do të oshëtinin
nga kënga jonë ushtarake,
sikur nën heshtjen taktike të marshimit
të mos rrinte

detyra luftarake.

KUR KISHA PARA DIVERSANTIN

Nëpër natë, si hije merrnin rrugët,
armatosur, burrat me qylaf.

Nga arat ishin kthyer, në rrëmuje.
Plot «maliherin» u nis edhe im at'

Ish verë. Mbi majë reflektonte hëna,
këndonte bulkhi në pullazet e shtëpive.
Ne fëmijve na kërkonin nënët,
të shqetësuara, nga portat e avllive.

Se ç'bëhej, ç'kishte ngjarë, kush s'na thoshte,
por nga gjëzimi i nënave morëm vesh,
se baballarët s'e kishin lënë të shkonte
qafirin, që më vonë, e prunë mes nesh.

M'u në sheshin tonë e shtrinë, tek furra,
mbi kokë, me pushkë i rrinte xha Fetani;
im atë më tej, me një tok burrash,
dikë mjekonin e thithnin fort duhanin.

Kur djersët fshinin të lodhur baballarët,
vështrimi ynë mbi objektiv kish hasur:
Nën dritën e kandilit për mbi vatër
njohëm sytë e Metkës sonë të dashur...

Oh, Metka është keq, na thoshin nënët.
Metka e ka plagën të vështirë.
Po Metka do shpëtojë, na thoshin zemrat
Dhe sytë e baballarëve tanë të mirë.

E si të vdiste, Metka kish fituar!
Metka prap në duar do t'na ngrinte,
se nën këmbët e tija i dëshpëruar,
armiku, humbjen në rënkim e shfrynte.

Kështu na kishte treguar një ditë
për plagët që kish marrë një partizan...
Ai po buzëqesh, na thoshin sytë
dhe dëshpërimi i qenit diversant.

B A L A D È

*Komisar Todi Pipës nga Myzeqeja, që ra
për të shpëtuar një ushtar nga vdekja.*

Nënët q'u përlotën,
Burrat rrudhën ballë,
rinia ja mori:
— Trim, o komisar!

Krahinat të futën
në folklor të gjallë:
— I deshe ushtarët,
shoku komisar!

Dëgjo Myzeqenë
shtruar arë më arë:
— Për ushtarin re,
bir, o komisar!

Dëgjo mëmëdhenë
në korin ushtar:
— Jeta jote ishte
luftë, o komisar!...

MBI MALE NATA DERDHTE HEROIZMIN

«O djemo, bashkë me «maliherin»
Të rinë të më sillni pranë;
t'ja dorëzoj siç e do nderi,
zakoni partizan.

Këtë dëshirë të plakut trim
mbi mua e lanë shokët,
vazhdimësi në shpirtin tim
për dhemshurinë e tokës.

Pranë tij unë, çuni faqendezur,
qëndroja shtyllë në këmbë.
Mbi mua derdhte trimërinë
mesnata, si me shtëmbë.

Oh, çdo furtunë do më gjente,
si një borigë në këmbë!...
Mbi male heroizmin nata
e derdhte si me shtëmbë.

P R A N V E R È

Mbi sheshe e brinja kanë dalë
Fëmijët plot zhurmë, si zgjoj,
të nisin «betejën» që lanë,
në mbrëmjen e natës që shkoi.

Në guvat këcet «mitralozi»
dhe thirrja: «Përpara, o shokë!
Armikun e ndyrë ta mposhtim
shtatë pash ta futim nën tokë!..»

Tek rri më afrohen, më thonë
(kur hidhen si Vojua mbi tank):
«Na shih, pra, shiko si sulmojmë,
o xhaxhi ynë, komandant!»

Dhe sulmi fillon nga e para
nën britmat: «Të mposhtëm armik!»

kush mundet t'u dalë përpara
ushtarëve të rinj, të çelikt?!

Po edhe njëqind herë t'ua ktheja
veprimin e hedhjes mbi tank,
të njëqintat herë, mes djersës,
do thoshnin: «S'u lodhëm, komandant!»...

NË DITËN E FESTËS SË ARTILERISË

Kish ulur krahët e gjëra perëndimi
mbi majë malesh në ngjyrë jargavani!...
Ç'e dridhte vallen ky, ushtar Kujtimi,
fizarmonikës i binte Arjani.

Muzikant s'do kish më të gëzuar
se sa ky djalë me gjoks si një bregore.
Të gjithë, të rinj e pleq, si të dashruar,
ishim në këtë festë të bukur popullore... .

Mësova me ushtarët këngës si t'ia marr
dhe hoqa sa djersita pogonishten...
Pastaj dëgjuam së bashku komisarë
Për artiljerët e Luftës të na fliste.

Si rendi nëpër vjetë hakmarrja e shqipes
mbi kuaj legjendarë në galop
gjer te ndërtesa e Asamblesë fashiste
të shfrynte dufin e shekujve me top.

KËSHTU DO TË THONË NIPËRIT TANË

1

Përmes këngëve të reja, që sjellin agimet shqiptare
çdo ditë
ne vijmë të armatosur me pajimet e punës e të
luftës.

Me bajoneta drejtuar si rrufepritëse për stuhitë,
duke kënduar këngën e ashpër të lirisë që erdhi
nga gryka e pushkës.

2

Do vijë një kohë, që në këtë rrugë varganë-varganë
të mblidhen nipërit për të mbjellë vetëm harenë
si një fidan të ri.

Do thonë: S'u lodhën kurrë nga betejat gjyshrit
tanë.

Do thonë: U rritën në betejat për liri...

33

Dhe ndonëse zemrat të ndjeshme i kishin si pranverat, dhe ndonëse në gjokset gurgullimë të përjetëshme kishin ritmet lirike, ata ishin pjellë e viteve të ndera, që kështjella vargëzonin nën rimat më epike...

4

Kështu do thonë të dashurit, nipërit tanë,
me sinqeritet e admirim,
kur të mblidhen këtu, varganë-varganë,
Për të mbjellë këngët si kujtim.

PLAKU, UNË DHE NDIHMËSMJEKU, LIPJA

*Një natë në repartin tonë në
Qafë të malit, erdhi një plak.
Ai kishte nipin shumë të sëmurë.*

...Dhe vraponim në acar, të dimrit,
mbi kurriz të maleve me pisha.
Një djalosh në jetë prap të sillnim,
plaku, unë dhe ndihmësmjeku, Lipja.

Duke trembur gjumin aq të mirë,
për të vrarë heshtjen nëpër natë,
duke çarë shteg në errësirë,
përmbi shpate llangosur në baltë.

Rruga shfaqej e zhdukej nën kulluzma
rruga gjarpëronte nëpër natë.

Thirrja «ndihmë» na digjte nëpër deje,
thirrja «ndihmë» nxitonte nëpër gjak.

Duke lënë mbrapa kilometra,
mbi kurriz të maleve me pisha,
Një ushtar të sillnim prapë në jetë
Plaku, unë dhe ndilmësmjeku, Lipja.

LETTER

E dashur nënë, e dashur motër,
e mora letrën tuaj!
Dhe unë e ndjej mallin e ngrohtë
që kini ju pér mua.

Veçse ajo që më kërkonat
(të vij në maj pa tjetër,
në ditë festë, kur më shumë
ne shtojmë vigjilencën)

nuk më pëlqen, t'u them të drejtën.
Po ti s'e di, moj nënë...
Eh, motër, motër, Antonetë
sa keq që s'ja ke thënë!

Ti artiljere je dhe vetë,
e njeh artilerinë.

Çdo një nga në në ditë festë
në qiel e ka synë...

Po do të vij patjetër unë,
Mbushur përmallime.
E 'do të rrimë gjer natën vonë
Rreth zjarrit shpuzë në vatër...

Tani me mall ju përqafoj
Po afron ora dhjetë
Dhe më pret radh' e shërbimit
Të shkoj atje pa tjetër...

NË POZICION

Ju dua juve, o shtigje luftëtarësh
Në diell dhe kur qelli ngarkohet me re.
Kështu, shtrirë barkaz me ushtarët,
Më ke aq pranë vetes, mëmëdhe!

«KAPITEN I VOGËL, MEMO NEXHIPI»¹⁾

Ballë kundrasulmesh thyhet qeni,
bëhet luftë e rreptë në kufi,
nga llogorja kapiteni Memo
mbi armiqtë vrojton me dylbi.

Bien shokë,
ç'e lan gjaku vendin...
— Djemo, është i shtrenjtë ky kufi.
Nuk e falim, jo asnje pëllëmbë
nga vendlindja jonë, Shqipëri!

Do të ngordhin këtu nën këmbët tonë,
do ta bëjmë armikun shkrumb e hi.
Bjeri, qerratait, bjeri, bëja forra
trim i Labërisë, Memo Nexhipi!...

Bëhet luftë e rreptë, buçet larg jehona.
Eh, plumb' i malkuar se ç'të mori ty!
ç'mbete të të thurin këngë malet tonë:
«Kapiten i vogël, Memo Nexhipi!»

1. U vra në provokacionet e gushtit në vitin 1949.

PEISAZH LUFTARAK

I çeli dritat anë e kënd mëngjezi
e grisi heshtjen ndër copra si me shpatë.
Kushtrimin për një ditë të re gjithkund e ndezi
nën tingujt e borisë në repart.

Ka kohë që presim të heshtur mbi djerrinë,
të nisemi pas urdhërit ushtarak...
Ç'na e derdh në zemër poezinë,
ç'na e derdh në shpirt trimërinë,
misioni i lavdishëm ushtarak.

D I S K U T I M

E çmund të bësh, vëlla, gjë tjetër,
kur shokët ngrenë zënë?...

Un' nis rrjeshtoj në copa jetë
ato që shkrova mbrëmë...

Pranë meje rri ky ushtar Lipja,
si një kritik i prerë
dhe s'i durohet të fillojë
nga vrejtjet menjëherë.

Kur unë mbaroj, atje me radhë
Çdo një fillon kritikën:
Dikush do më shumë ndjenjë dhe vargje,
Një tjetër mbron metrikën.

Mësuesi i gjuhës përpunime
Në varg kërkon dhe pak...
I sigurtë pranë këtij mendimi
Po vjen shoferi Vaskë.

Dhe Memo labi s'mbeti bosh:
Vëllezër — tha — pér mua,
Që dimëroj me dhen në Borsh,
Këto lloj vjersha dua, ..

Ç'u ndezën gjatë diskutimet,
Kritika mori flakë
S'mbeti njeri pa dhënë mendime,
Pa folur sado pakë.

Dhe vijnë ato në mendjen time,
Si një buzëqeshje e çiltër vijnë.
E, unë mësoj sot nga ushtarët
Kaç shumë pér poezinë.

BALADË PARTIZANE

Sillet, çfrym era e janarit
lisat egër fshikullon.
Trimit shtrirë buzë zallit
faq' e tretur i zverdhon.

Rreth i rrinë, vetull vrejtur,
shokët ngjeshur me kollan.
U shkëlqen mbi ball të rrreshkur
Ylli i zjarrtë partizan.

Ngrirë duart përmbi pushkë,
ngrirë këmbët në kallkan,
porse etja e hakmarrjes
rritet, rritet si vullkan.

Për një shok të mirë që lanë,
në një pritë mbi Prongji,
tek thërriste: «Për vatanë
para, para shokëni! . .»

Ç'do t'u thoshte nënë Lemja,
Kur t'i shkonin që të katër?
S'do vajtonte nënë Lemja,
do t'i mblidhte pranë, në vatër.

Do t'i ligjéronte nëna:
— Djalë ty, nëna trim të ka —
Ta dëgjonin njerëzit nënën
Atje lart në fshatra.

Duart ngrirë përmbi pushkë
këmbët ngrirë në kallkan,
do t'ua shkrinte nënë Lemja
rreth oxhakut partizan...

ÇAST PUSHIMI ME USHTARËT

Kundërmon korija nën diell
Bari i njomë — qilim jeshilon.
Ç'ja thotë ushtar Shemja me fyell:
Zogjtë përmbi lisa gjallëron.

Heshtin komandanti dhe ushtarët.
Melodiaëmbël vjen e shkon.
Labit ç'i kujtohet fshat' i dashur,
me gishtrinjtë luan tér' pasion...

I kujtohen në nome çobanët
mbrëmjeve, kur rrinë e kuvëndojnë...
Më të rinjtë në dorë gazetat mbajnë
Dhe më pleqve lajmet u lexojnë.

Merr me mend si nisen pas kopesë:
Një me fyell, tjetri me longar,
duke sokëllitur herë pas here
për të trembur ujkun grabitqar...

Dhe humbet djaloshi në mendime
nën tingujt e fyellit të tij,
por shakatë e dashura të shokëve
plot humor, e futin prapë në gji.

Përmbi shtrungë si shkëlqen një llampë
Dhe një radio zien në nome
Bashkë i ngjitën shtyllat majë më majë
Dhe e çuan dritën gjer atje...

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Në shtëpi	3
Me ty, o komandant	4
Basho Cilja	6
Çast	9
Motiv i blertë	11
Mbrëmja në pushim	12
Kështu më thanë	13
Ritëm malesh	15
O komisar i çetës	17
Sonte	19
Kur kisha para diversantin	20
Baladë	22
Mbi male nata derdhët heroizmin	24
Pranverë	25
Në ditën e festës së artilerisë	27
Kështu do të thonë nipërit tanë	28
Plaku, unë, dhe ndihmësmjeku Lipja	30
Letër	32
Në pozicion	34
Kapiteni i vogël, Memo Nexhipi	35
Peisazh luftarak	36
Diskutim	37
Baladë partizane	39
Çast pushimi me ushtarët	41

56615

BIBLIOTEKA E SHT^TTIT
GJIROKASTER

Tirazhi 3000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1971